

1. SILABUSET E MODULEVE

1.METODAT E MESIMDHENIES & MENDIMI KRITIK

Metodologji e mësimdhënies është shqyrtimi dhe studimi i praktikave më të përdorshme dhe të përshatshme sot në procesin e mësimdhënies në të gjitha nivelet dhe llojet e shkollimit, i klasifikimit të karakteristikave të çdo modeli, natyrës, evoluimit dhe zhvillimit të secilit prej tyre, shqyrtimin e aspekteve të metodave të mësimdhënies, të menduarit kritik përmes metodave të të nxënësve aktiv, aspekteve psikologjike të zbatuara në mësimdhënie dhe aftësimi i studentëve më pas për të zhvilluar kurrikulën dhe planifikojnë mësimin.

Lënda ka karakter modular.

Moduli 1: Metodatat e mësimin

Metodat e mësimin trajtohen me të gjithë elementet e tyre, duke filluar nga objektivat mësimore, planifikimi i mësimor, zhvillimi i metodave ndërvepruese që nxitin të nxënësve aktiv, dhe deri te vlerësimi i nxënësve

Moduli 2: Të menduarit kritik

Qëllimi i këtij moduli është të ofrohen shprehite me kryesore që u mundësojnë studentëve, mësues të ardhshëm, të japin mësim për zhvillimin e gjithanshëm intelektual të nxënësve për shprehite e të menduarit kritik.

Për të përgatitur qytetarët për shoqërinë e dijes janë përcaktuar shprehite bazë (disa herë të emërtuara edhe kompetenca), që duhet të përpunojë shkolla. Ato përbëjnë një tërësi njohurish, shprehish dhe vlerash, që u nevojiten individëve për zhvillimin e tyre të gjithanshëm. Të gjitha këto duhet të zhvillohen deri në fund të arsimit të detyruar dhe duhet të shërbejnë si bazë për të mësuar më tej si pjesë e të nxënësve afatgjatë.

Pjesë e këtyre njohurive e shprehive janë edhe ato të të menduarit kritik, të zgjidhjes së problemit, të përpunimit të informacionit, të të nxënësve në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me të tjerët. Procesi i mësimdhënies dhe i të nxënësve, që synon përmbushjen e cilësive të qytetarëve të shoqërisë së dijes me të gjitha shprehite e mësimore, në të gjitha vendet me arsim të zhvilluar, bazohet te konstruktivizmi.

Konstruktivizmi është mënyrë për të kërkuar rrugë më të efektshme të mësimdhënies dhe të të nxënësve. Me metodatat tradicionale studiuesit dhe mësuesit kanë vënë re cektësi në të kuptuarit e nxënësve dhe njohuri pasive në të gjitha moshat dhe klasat, përfshirë këtu edhe universitetet.

Moduli 3: Psikologjia e zbatuar në mësimdhënie

Ky modul bazohet në modelin kognitiv, kryesisht në konstruktivizmin, si filozofi dhe si praktikë arsimore i aftëson individët të veprojnë në mënyrë aktive. Të menduarit dhe njohuritë shkojnë krahas për krahas. Ne duhet të kemi njohuri, që të mendojmë rreth diçkaje. Sa më shumë dimë rreth diçkaje, aq më shumë jemi në gjendje të kritikojmë, analizojmë apo vlerësojmë.

Aftësimi i studentëve për të menduar, për të parë lidhjet dhe marrëdhëniet si dhe për të bërë vetë zbulim se duhet të jetë përparësi e mësuesve në ditët e sotme.

Moduli 4: Zhvillimi i kurrikulës

Moduli për zhvillimin e kurrikulës dhe të planifikimit të mësimin, ka për qëllim t'i aftësojë studentët, mësues dhe punonjës të ardhshëm të arsimit në zbatimin konkret të tyre në klasë, duke zbatuar parimet teorike të kësaj fushe. Temat përfshijnë hartimin e kurrikulës, qëllimet, synimet dhe objektivat, zbatimin e kurrikulës, hartimi i mësimdhënies duke marrë parasysh përvojat e të nxënësve. Ky modul do të shpalosë një mënyrë të re të hartimit dhe zbatimit të tij në shkollë dhe do të ndikojë në përmirësimin e praktikave të mësimdhënies.

Qëllimet e lëndës

Nëpërmjet kësaj lënde ofrohet një llojshmëri informacioni mjaft modern për metodat e mësimdhënies të trajtuara në këndvështrimin kognivist dhe konstruktiv si edhe pajisja e studentëve me shprehitë e domosdoshme për t'i zbatuar ato në klasë apo në institucionet arsimore

Objektiva e lëndës

Në përfundim të lëndës, studentët do të jenë në gjendje:

- Të njohin dhe dallojnë metodat më kryesore të mësimdhënies
- Të klasifikojnë karakteristikat kryesore të metodave të mësimdhënies
- Të evidentojnë rezultatet e studimeve sipas përvojave të ndryshme
- Të zbatojnë modelet moderne të mësimdhënies në sistemin tonë arsimor
- Të gjykojnë në mënyrë të pavarur modelet ekzistuese
- Të fitojnë shprehitë kryesore të të menduarit kritik
- Të dallojnë parimet e të nxënësve aktiv dhe të menduarit kritik
- Të zotërojnë metodat dhe modelet e mësimdhënies për të menduarit kritik
- Të zotërojnë të kuptuarit e zhvillimit dhe të hartimit të kurrikulës dhe marrëdhëniet e tij me metodat dhe modelet e ndryshme të zbatimit.
- Të kuptojnë procesin prej të cilit është bërë formulimi, është bërë zhvillimi dhe është bërë zbatimi i kurrikulës
- Të planifikojnë strategji të përshtatshme të mësimdhënies.

Përmbajtja e lëndës

Mësuesi, mësimdhënia dhe mjeshtëritë e saj. Qëllimet dhe objektivat

Planifikimi i mësimit. Metodatat e mësimdhënies ndërvepruese: Analiza e tipareve semantike. Diagrama piramidale. Harta e konceptit/përkufizimit. Imagjinata e drejtuar. Marrëdhëniet pyetje-përgjigje. Organizuesi grafik i analogjisë

Metodat e mësimdhënies ndërvepruese: Përmbledhja pohim-mbështetje. Përvijimi i të menduarit kritik. Rrjeti i diskutimit. Shënime mbi shënime. Sistemi ndërveprues i shënimeve.

Procesi dhe mjeshtëritë e të pyeturit. Pyetja sjell pyetjen. Pyetje autorit.

Vlerësimi i nxënësve. Testet e ndërtuara nga mësuesi

Të menduarit kritik: Historiku dhe bazat

Të menduarit shkollor dhe gjuhë shkollore dhe shprehitë e mësuesve për zhvillimin e të menduarit kritik, gjuhës dhe përmbajtjes.

Shprehitë e të menduarit kritik

Analiza. Krahasimi. Kategorizimi dhe klasifikimi. Identifikimi i shkakut dhe pasojës.

Shprehitë e të menduarit kritik

Zgjidhja e problemeve. Vënia e vetes në pozitën e tjetrit. Sintezë. Interpretimi. Vlerësimi. Komunikimi. Zbatimi

Strategjitë e të menduarit kritik në klasat mendimtare

Psikologjia në mësimdhënie. Inteligjencat e shumëfishta

Konstruktivizmi dhe të nxënësve ndërveprues

Koncepti për kurrikulën. Fusha e kurrikulës, parimet bazë

Bazat filozofike dhe historike të kurrikulës

Bazat psikologjike dhe sociale të kurrikulës

Teoria e kurrikulës

Zhvillimi i kurrikulës. Metodatat e zhvillimit të kurrikulës
Elementet që marrin pjesë në zhvillimin e kurrikulës
Pjesëmarrja në zhvillimin e kurrikulës
Zhvillimi i kurrikulumit në nivel shkolle. Përparësitë dhe mangësitë.
Hartimi i kurrikulës: Synimet, Qëllimet, Objektivat
Pjesët përbërëse të hartimit të kurrikulës
Modelet përfaqësuese të kurrikulës
Qëllimet, synimet dhe objektivat e arsimit
Nivelet klasifikuese.
Metodat e përcaktimit të objektivave mësimore
Zbatimi i kurrikulës
Natyra e zbatimit të kurrikulës
Zbatimi si proces ndryshimi
Modele të zbatimit të kurrikulës
Vlerësimi i kurrikulës

Detyrimet e studentit

Pjesëmarrje jo më pak se 60-70% në leksione dhe në veprimtari praktike
Mbrojtje individuale apo në grup të një punimi dhe dorëzimi I saj në përfundim të lëndës sipas kriterëve të përcaktuara.
Për aktivizimin në seminare, pjesëmarrjen, veprimtaritë praktike dhe plotësimin e detyrave të mësipërme, student vlerësohet me pikë deri në kufirin minimal të kalimit. Ai/Ajo hyn në provim nëse paraprakisht ka grumbulluar 25-30 pikë (5-10 pikë për aktivizim dhe deri në 20 pikë për punimin e mbrojtur).
Provimi zë 70% të vlerësimit përfundimtar.

Vlerësimi

Aktivizim në seminare dhe pjesëmarrje në veprimtari praktike	10%
Detyra e kursit	20 %
Testi përfundimtar	70%

Literatura

-Musai Bardhyl, (2003) Metodologji e mësimdhënies, Tiranë: Pegi
-Joyce, Bruce,. Weil, Marsha & Calhoun, Emily (2000) Models of Teaching, botimi i gjashtë. Allyn & Bacon;USA
-Tekst bazë: Zëiers, J (2005) Zhvillimi i shprehive të të menduarit në klasat 6-12. Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik
-Musai, B (2005) Mësimdhënia dhe të nxënit ndërveprues-Metoda për zhvillimin e të menduarit kritik. Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik
-Crawford, A., Saul W., Mathews, R. S., & Makinster, J. (2005) Teaching and Learning Strategies for the Thinking Classroom. New York: The International Debate Education Association.
-Snowman, Jack & Biehler, Robert (2003) Psychology Applied to Teaching, botim i dhjetë, Houghton Mifflin:USA
-Wiggins, Grant & McTighe, Jay (2001) Understadning by Design . Merrill Prentice Hall:USA
Orstein, A.C., & Hunkins, F.P. (20003), Kurrikula, parimet dhe problemet, Allyn & Bacon:USA

2. PSIKOLOGJI ZHVILLIMI

Hyrje

Psikologjia e Zhvillimit është ajo degë e Psikologjisë që merret me studimin e tërësisë së ndryshimeve emocionale, biologjike dhe fizike që ndodhin te individi nga momenti i konceptimit gjer në vdekje. Në Psikologjinë e Zhvillimit do të studiohet zhvillimi fizik, kognitiv dhe psikosocial i fëmijërisë së mesme dhe adoleshencës. Këto 2 periudha zhvillimi do të studiohen jo vetëm për karakteristikat e tyre, por edhe në aspektet e shkollave/rrymave të ndryshme në psikologji që kanë ofruar teori të larmishme mbi zhvillimin e individit.

Qëllimet e Kursit:

T'ju njohë me zhvillimin fizik, kognitiv dhe social të individit për periudhat e fëmijërisë së mesme dhe adoleshencës

T'ju njohë me konceptet bazë si dhe me metodat që përdoren për ta studiuar zhvillimin e individit.

T'ju njohë me ndryshimet që ndodhin në procesin e të menduarit në lidhje me kalimin nga mosha e mesme shkollore deri në adoleshencë.

T'ju shpjegojë teoritë që e sqarojnë mënyrën sesi ky proces evoluon dhe cilët janë faktorët që e ndikojnë.

Objektivat e kursit:

Me përfundimin e suksesshëm të këtij kursi, studenti do të jetë i aftë të:

Të diskutojë për psikologjinë e zhvillimit si fushë studimi

Të ketë njohuri bazë për proceset fiziologjike, emocionale, kognitive të zhvillimit të individit gjatë periudhës së fëmijërisë së mesme dhe adoleshencës

Të kuptojë sjelljen e individëve në fëmijërinë e mesme dhe adoleshencë dhe faktorët që e ndikojnë atë.

Përmbajtja e kursit:

1. Hyrje në psikologjinë e zhvillimit

Ç'është psikologjia e zhvillimit. Objekti dhe synimet e psikologjisë së zhvillimit. Karakteristikat e zhvillimit. Periudhat e zhvillimit. Objekti dhe historia e shkurtër e psikologjisë së zhvillimit. Konceptimet historike lidhur me fëmijërinë. Konceptimet filozofike lidhur me fëmijërinë.

2. Teoritë për zhvillimin njerëzor

Teoritë psikanalitike: teoria psikoseksuale e Frojdit. Stadet e zhvillimit psikoseksual. Teoria e Eriksonit – teoria e zhvillimit psikosocial te Eriksonit. Stadet e zhvillimit psikosocial. Teoritë kognitiviste – teoria kognitiviste e e Piaget. Teoria e procedimit të informacionit. Teoria e Lev Vogotskit.

3. Teoritë për zhvillimin njerëzor

Teoritë bihejvioriste – teoria e kushtëzimit. Kushtëzimi klasik. Kushtëzimi operant. Teoria sociale e të mësuarit – teoritë humaniste. Etologjia. Orientim eklektik.

4. Bazat biologjike të zhvillimit

Si kryhet riprodhimi njerëzor? Infertiliteti. A mund te korrigohet? Cilat janë mekanizmat e trashëgimisë? Çfarë është këshillimi gjenetik.? Si ndërveprojnë gjenet dhe mjedisi për të prodhuar fenotipin.

5. Zhvillimi para lindjes dhe procesi i lindjes

Periudha e zhvillimit para lindjes. Kalimi nga bota brendauterine ne boten jashte uterine. Mjedisi prenatal dhe ndikimet e tij ne zhvillimin e fetusit. Procesi i lindjes. Praktikrat e lindjes. Komplikimet e lindjes. Eksperienrat stresante te femijes. Femijet e parakoheshem...a mund te mbijetojne. Femijet e lindur me vonese a kane probleme? Periudha pas lindjes

6. I sapolinduri

A ka nje i sapolindur nje pamje fizike te bukur. Funksionimi fiziologjik i te sapolindurit. Cfare kompetencash ka i sapolinduri. Kapacitetet shqisore dhe perceptive te te sapolindurit

7. Zhvillimi fizik dhe kognitiv ne foshnjeri

Zhvillimi fizik, ndryshimet ne permasa dhe proporcione. SVFP-ja. Tretja, dieta te ushqyerit. Zhvillimi motorik. Zhvillimi perceptiv. Zhvillimi kognitiv, Kujtesa e femijeve. Teoria e Piazhese. Stadi sensomotorrik.

8. Zhvillimi psikosocial ne foshnjeri

Kontributi i femijes. Karakteristikat fizike, shendeti i femijes, Temperamenti, Emocionet e foshnjes. Kur fillon frika? Kontributi i prinderve. Atashimi prind femije. Ankthi nga te panjohurit dhe ndarja nga figura atashuese. Zhvillimi i konceptit per veten. Teoria e ndarjes dhe individualizimit e Margaret Mahler. Studimi per vetedijen. Komunikimi prind-femije. Sjelljet pre-gjuhesore

9. Zhvillimi fizik e kognitiv ne moshen parashkollore

Zhvillimi fizik. Proporcionet e trupit, pesha lartesia dhe pamja. Ndryshimet strukturore, Zhvillimi i trurit. Shendeti ne moshen parashkollore. Zhvillimi motorik. Shprehite e medha motorike, shprehite fine motorrike. Zhvillimi kognitiv. Stadi paraoperacional i te menduarit i Piazhese. Kufizimet e te menduarit paraoperacional. Teoria e procesimit te informacionit

10. Zhvillimi gjuhesor ne moshen parashkollore

Nje sintheze per gjuhen dhe komponentet te saj. Sekuenca e zhvillimit gjuhesor ne qeniet humane. Zhvillimi gjuhesor ne moshen parashkollore. Komunikimi i parashkolloreve. Bilingualezimi. Si pervetesohet gjuha.

11. Zhvillimi psikosocial ne moshen parashkollore

Zhvillimi i konceptit per veten. Koncepti per veten. Formimi i roleve gjinore. Familja dhe femija. Efekti i divorcit tek femijet Marredheniet me moshataret dhe loja Marredhenia me vellezrit, gjysherit. Efekti i TV tek parashkolloret. Stresi tek ta. Crrregullimet e gjumit. Abuzimi feminor. Parashkolloret dhe loja

12. Zhvillimi fizik e kognitiv ne femijerine e mesme

Karakteristikat e zhvillimit fizik. Diferencat ne zhvillimin fizik mes vajzave. Zhvillimi motorik. Koha e reagimit. Shendeti. Zhvillimi kognitiv ne femijerine e mesme. Pikepamja e Piazhese. Zhvillimi kognitiv sipas teorisë se procesimit te informacionit. Stilet kognitive.

13. Zhvillimi psikosocial ne femijerine e mesme

Zhvillimi i konceptit per veten. Vetevleresimi. Zhvillimi i kognicionit social. Zhvillimi i arsytimit moral. Marrredheniet me moshatarët. Familja dhe femija.

14. Zhvillimi fizik e kognitiv ne moshen e adoleshencës

Kufijtë e adoleshencës. Zhvillimi fizik. Sjellja seksuale ne adoleshencë. Zhvillimi kognitiv ne adoleshencë. Piage – stadi i operacioneve formale. Zhvillimi kognitiv ne adoleshencë sipas teorisë se procesimit te informacionit. Ndryshimet ne qellimin dhe dhe permbajtjen e mendimit te adoleshentëve.

15. Zhvillimi psikosocial ne adoleshencë

Formimi i identitetit. Koncepti i Erik Eriksonit per identitetin. Pikepamja e Xheims Marcias per identitetin. Diferencat gjinore ne lidhje me identitetin. Adoleshenti dhe familja. Adoleshentët dhe moshatarët. Përfshirja e adoleshentëve ne sjellje riskuese. Depresioni dhe vetëvrasja ne adoleshencë.

Detyrimet e studentit

Kursi përmban këto kërkesa kryesore pa përmbushjen e të cilave nuk kualifikohet për vlerësimin final:

Takimi me pedagogun në datat zyrtare të takimeve për kursin në fjalë sipas njoftimeve që pasqyrohen në orarin zyrtar të Fakultetit. Sipas rregullores së fakultetit, studenti nuk duhet të mungojë në më shumë se 20% të kohës së seminareve, pasi nuk do të lejohen të marrin pjesë në vlerësimin final.

Studenti ka detyrim të hyjë në provimin përfundimtar.

Për arsye të ruajtjes së qetësisë dhe mjedisit në klasë, studentët nuk lejohen të hyjnë me vonesë në auditor.

Ndalohet përdorimi i aparateve elektronike gjatë orës së mësimit pa asnjë lloj përjashtimi.

Vlerësimi i kursit

Studenti i këtij kursi vlerësohet për këta komponentë:

1	Pjesëmarrja aktive përgjatë seminareve	20%
2	Detyrat	25%
3	Provimi Përfundimtar	55%

Literatura

“Psikologjia e Zhvillimit të Fëmijës” botim i dytë, Prof. Dr. Theodhori Karaj, 2005

Përveç librit, gjatë orës së seminareve do të ketë edhe materiale të tjera si edhe faqe interneti.

3. TEORITE E TE NXENIT

I. Hyrje

”Teorite e te nxenit” është një nga tre modulet e lëndës “Psikologji edukimi”, që zhvillohet me studentet e ciklit të dytë të studimeve, master i nivelit të parë në degën e mesuesisë.

Nepermjet tij, studentet marrin njohuri të zgjeruara për të nxenët si proces shumë i rendesishëm në formimin dhe edukimin e nxenesit. Te nxenit e nxenesit ze një vend shumë të rendesishëm në synimet dhe objektivat mesimore të mesuesit. Përgatitja e mesuesit për një mesimdhënie të këndshme, në përshatje me nxenesit dhe aktivitetet gjatë zhvillimit të mesimit për të arritur rezultate efektive i shërbejnë pikërisht të nxenit, madje edhe vlerësimi i nxenesve që është pjesë e tretë e procesit ka si objekt pikërisht vlerësimin e këtij të nxeni. Në këtë këndvështrim, të nxenit merr pamjen e një objekti qendror në tabllon e PME dhe nga ana tjetër një burim ku duhet të orientohet mesimdhënia dhe të mbështetet vlerësimi.

Te nxenët ka të bëjë pikërisht me nxenesin, prandaj metodologjitë bashkëkohore synojnë ta vënë nxenesin në qendër të procesit dhe nxitin teknika të cilat i japin me shumë përfshirje atij dhe ekpërvojave paraprake që sjellin nxenes të ndryshëm me diversitete të larmishme kulturore, njohjeje dhe aftësie. Edhe në qendër të këtij kursi do të jetë studenti, i cili do të udhëhiqet nga pedagogu për të hulumtuar e ndërtuar produkte autentike në këtë fushë.

Gjatë këtij kursi studenti nuk do të mjaftohet vetëm me marrjen e njohurive teorike mbi të nxenët dhe teorive që njihen në historinë e psikologjisë së të nxenit, por do t'i meshohet fort edhe trajtesave të problemeve praktike që hasen në jetën e shkollës dhe në atë të nxenesit.

Seminaret, trajtesat, detyrat e kursit, ilustrime te ndryshme do te ndihmojne fuqishem ne kete drejtim.

Ky kurs shtrihet ne nje semester. Me te mund te siguohen tre kredite Gjate kursit studentet do te takohen me pedagogun dy here ne jave, 4 ore ne provimin final.

II. Qellimet e kursit

Kursi "Teorite e te nxenit" synon:

1. Te ndihmoje studentin per te njohur teorite e te nxenit, te kuptojne logjiken dhe zbaimin e tyre dhe te arrijne te bejne evidentimin e tyre ne sjellje apo demonstrime te ndryshme gjate performances se nxenesit.
2. Te njohe studentet me nje mori teknikash qe perdor nxenesi gjate te nxenit
3. Te ndihmoje studentin qe ne rolin e mesuesit te zbatoje teknika qe nxitin te nxenin efektiv te nxenesit.

III. Objektivat e kursit:

Ne fund te ketij kursi studentet do te jene i afte:

1. Te japin nje percaktim te sakte mbi kuptimin konceptual te te nxenit.
Te shpjegoje permbajtjen thelbësore te disa prej teorive kryesore te te nxenit (bihevizmit, konjektivizmit, konstruksionizmit) dhe te teorive te tjera qe lidhen me to.
2. Te permendin faktoret dhe te argumentojne ndikimin e tyre tek te nxenet.
3. Te permendin tipet e te nxenit dhe t'i dallojne ato ne nje ilustrim te dhene duke argumentuar mbi konceptet perkatese.
4. Te pervesojne koncepte si kushtezim klasik, reflekset e kushtezuara, konjektivizmi kushtezimi operant, perforcim, etj.
5. Te pervesojne teknikat e problemzgjidhjes gjate procesit te te nxenit dhe te jene te afte per t'i aplikuar ato ne ne njesituae konkrete.
6. Te percaktojne straegjite qe i ndihmojne nxenesit te kuptojne faktet dhe shprehite baze te diturive.
7. Te pervesojne modelin baze te zgjidhjes se problemit dhe te jene ne gjendje ta zbatojne ate ne kushtet konkrete.
8. Te identifikojne dobesite e nxenesve ne shprehite e zgjidhjes se problemit per t'i permiresuar ato
9. Te pervesojne disa nga veshtiresite e nxenesve ne te nxene si dhe te aftesohen ne aplikimin e teknikave qe lehtesojne nxenesit ne zgjidhjen e dilemave te tyre ne te nxene.

IV. Permbajtja analitike e kursit

Te nxenet - pershkrimi pergjithshem. Format e thjeshta te nxenit. Kushtezimi klasik dhe parimet e tij. Eksperimenti i Pavlovit . Aplikimi i kushtezimit klasik.

Teorite bashkekohore. Kushtezimi operant. Ligji i efektit te Thorndaikut. Pikpamja e Skinnerit. Parimet e kushtezimit operant.

Natyra e perforcimit. Skema e perforcimit. Ndeshkimi. Kategorite e ndeshkimit. Si funksionon ndeshkimi. Aplikime te kushtezimit operant.

Format e te nxenit. Te nxenet nepermjet vezhgimit. Eksperimenti i Bandures, Teoria e imitimit (Bandura) Te nxenet social kognitiv Shpjegimi i modelimit .Vetefikasiteti.

Teoria sociale e te nxenit. Teoria e imitimit te pergjithesuar. Faktoret e imitimit te ndikuar. Influenca e televizorit..

Te nxenet gjuhësor, te nxenet me te lexuar e te degjuar. Formimi i koncepteve.
 Teorite e te nxenit Bazat e teorive te te nxenit. Behaviorizmi, Kognitivizmi, Konstruksionizmi,
 Teorite informale dhe postmoderne. Evolimi i dy teorive
 Faktoret qe ndikojne ne afesite e te nxenit. Mosha. Motivimi. Eksperienca paraprake.
 Inteligjenca. Veshtiresite ne te nxene dhe aftesite e kufizuara.
 Zgjidhja e problemit. Strategjite e zgjidhjes se problemeve. Zgjidhesi i mire i problemeve. Modeli
 DUPE. PISASH, SPLRP.
 Percaktimi i natyres se problemit. Kuptimi i natyres se problemit.
 Planifikimi i zgjidhjes. Roli i kujteses ne zgjidhjen e problemit. Vleresimi i zgjidhjes
 Nxenesi krijues. Mesimdhenia e teknikave te zgjidhjes se problemit. Te ndihmojme nxenesit per
 te transferuar te nxenet e tyre .
 . Rekomandime per punen ne klase. Paraqitja grafike e modelimit te brendshem te problemit.
 . Motivimi ne klase. C'eshte motivimi?. Pikpamja biheavioriste te motivimit. Pikpamja
 kognitiviste te motivimit.
 Drejtimet humaniste ne motivim.
 Ndikimet e motivimit mbi te nxenet. Ankthi ne klase.

V. Detyrimet e studentit universitar

1. Pjesëmarrje në leksione dhe frekuentim aktiv në seminare sipas njoftimeve te shpallura ne orarin zyrtar te fakultetit.
2. Gjatë kursit studentët punojnë individualisht për realizimi i një detyre kursi, e cila duhet t'u referohet problemeve te te nxenit formal, sfidave dhe dilemave te te nxenit. Detyra e kursit ndërtohet mbi bazën e problematikave që sjellin raste të veçanta apo situata konkrete të marra nga realiteti ynë shkollor, duke studiuar raste nepermjet evidentimit te te dhenave, perpunimit dhe trajtimit te tyre mbi logjiken e njohurive te marra nga kursi: “Teorite e te nxenit”. Në fund të semestrit detyrat referohen sipas një prej temave të paracaktuara gjatë seminareve.
3. Studenti ka detyrim te studioje literaturen e rekomanduar ne rubriken VII.
4. Testimi përfundimtar. Në përfundim të kursit dhe pas shlyerjes së detyrimeve të njohura më parë, studentit i nënshtrohet provimit përfundimtar me shkrim në formë testi. Provim me shkrim i detyrueshëm, i cili do të bazohet në pyetje të hapura dhe te mbyllura mbi temat e trajtuara gjate leksioneve.

VII. Vlerësimi.

Studenti i ketij kursi vleresohet per keta komponente:

Nr	Kriteri i vleresimit	Perqindja
1	Prezenca e tij fizike dhe shkalla e aktivizimit te tij ne diskutimet gjate seminareve	10%
2	Cilesia e detyres se tij te kursit. (Ne se do te zgjedhe kete modul)	20%
3	Sasia e pikeve te grumbulluara ne provimin perfundimtar.	70%
4	Totali	100 %

VII. Literatura

Dale H. Schunk: "Learning Theories" Learning theory (education)
Bardhyl Musai "Psikologji e edukimit"

Franko Frabboni & Franca Pinto Minerva Dimitrios Thanasoulas "Manuali i pedagogjise"
Constructivist Learning
Bardhyl Musai "Psikologji e edukimit"
A. Tamo, Th Karaj, E. Rapti "Mesimdhenia dhe te nxenet"

VIII. Kontakti

1. Kontaktimi ne auditor do te behet ne datat dhe oren e percaktuar ne orarin e shpallur apo te afishuar ne kendin perkates.
2. Ne se so t'ju duhet te kontaktoni per udhezime apo keshillime qe lidhen me plotesimin e nevojave te lendes mund te lidheni elektronikisht me adresen
E-mail: zenelsina@hotmail.com. ose ne numer telefoni celular:
3. Temat e e detyres se kursit duhet te propozoni dhe t'i miratoni me pedagogun para se te filloni punen per hartimin he zhvillimin e tyre. Miratimi behet mbi bazen e miratimit te nje permbledhje te permbajtjes se temes te pershkruar deri ne 15 rreshta.

IX Aneksi. Puna e pavarur

Puna e pavarur eshte nje dokument empirik, ku perfshihet informacioni i grumbulluar, shpjegimi i te dhenave dhe nxjerrja e konkluzioneve perkatese.

Qellimi i kesaj detyre eshte t'i mundesoje studentet te zhvillojne dhe te permiresojne shkathtesite kerkimore shkencore ne fushen e psikologjise te te nxenit.

Studenti do te zhvilloje vetem nje detyre kursi per te tre modulet e psikologjise se te edukimit. Ne se ai zgjedh nje detyre me tematike nga moduli i teorive te te nxenit, atehere ai eshte i detyruar t'u nenshtrohet ketyre rregullave.

Struktura e punimit

Punimi duhet te perbehet nga keto pjesë kryesore

- Hyrja
- Shqyrtimi i literaturës së fushës dhe të çështjes
- Diskutimi
- Përfundime dhe propozime
- Bibliografia

Hyrja. Seksioni i hyrjes duhet të prezantojë, çështjen e marrë në studim, rendesine dhe arsyet e zgjedhjes se saj, të përmbledhë informacionin e rëndësishëm dhe strukturën e punimit.

Shqyrtimi i literaturës së fushës dhe të çështjes. Në këtë pjesë paraqiten kontributet e studiuesve të ndryshëm për çështjen e marrë në studim.

Diskutimi. Ky seksion përmban krahasimin e rezultateve te studiusve te ndryshem dhe interpretimin e rezultateve. Jepet qendrimi juaj per problemin e marre ne studim. Gjithashtu, në këtë pjesë paraqitet kritika për çështjen e marrë në studim dhe bëhen komente.

Përfundime. Ky seksion përmbledh gjetjet kryesore të studimit.

Propozime të tjera. Ky seksion nuk është i detyrueshëm dhe kërkohet vetëm nëse rezultatet justifikojnë kërkimin e mëtejshëm.

Literatura

Të gjitha punimet shkencore duhet të përdorin literaturën dhe për citatet të tregojnë burimin e tyre. Seksioni i bibliografisë duhet të vendoset në faqe më vete.

Të gjithë kapitujt, çështjet, rubrikat e studimit renditen me rend numerik.

Kërkesa teknike për punimin shkencor

Punimi duhet të jete jo me pak se 8 faqe formati A4 dhe jo me shume se 15 faqe, mundesisht i punuar ne kompjuter. Punimi duhet të jete i lidhur. Në kopertinë duhet të vendoset emri i universitetit, i fakultetit, i deges, titulli i plotë i temës, emri i studentit, , viti shkollor.

Vendi që zënë elementet e punimit

Hyrja 10 %

Shqyrtimi i literaturës së fushës dhe të çështjes 30%

Diskutimi 45%

Përfundime 10%

Bibliografia 5%

Shtypja

Materiali duhet të shtypet vetëm nga njëra anë e letrës.

Cilësia e shtypjes

Vetëm një lloj shkrimi duhet përdorur. Lloji i shkrimit duhet të jetë Bookman Old Style. Masa e shkronjës duhet të jetë 11-she.

Numrat e faqeve

Të gjitha numrat e faqeve duhet të vendosen poshtë dhe në mes të faqes.

Hyrja duhet të ketë numra romakë.

Pjesa e studimit duhet të ketë numra arabë.

Kriteret e vlerësimit

NR	KOMPONENTET VLERESUES	MINIMALE	MESATARE	MAKSIMALE
1	Pasuria faktike: vezhgime, diskutime, raportime	1	2	4
2	Operacione me konceptet: sasia dhe daktesia e koncepteve te perdorura	1	2	4
3	Thellesia e analizes, lidhja e koncepteve me njeri-tjetrin dhe kuptimi i ceshtjes	1	2	4

4	Besueshmeria e propozimeve: Lidhja e tyre me faktet dhe perfundimet e analizes	1	2	4
5	Koncepti shprehes; pasuria, saktesia dhe qartesia e gjuhes se perdorur	1	2	4
6	Paraqitja teknike: sipas udhezimit te dhene.	1	2	4

4.VLERËSIMI

Hyrje

Lënda është e destinuar për studimet në Programin Mmaster i Shkencave në Mësuesi.

Ajo përbëhet nga në tri pjesë. Në pjesën e parë përfshihen tema të cilat trajtojnë bazat e matjes dhe të vlerësimit në arsim. Objekt i pjesës së dytë janë bërë temat për instrumentet e matjes. Nga shumëllojshmëria e instrumenteve të matjes janë veçuar testet objektive dhe subjektive, testet e standardizuara, testet e përgatitura nga mësuesi si dhe procedurat e vrojtimit të përditshëm. Pjesa e tretë i kushtohet praktikave të realizimit të matjes dhe të vlerësimit. Në këtë pjesë janë përfshirë çështjet kryesore që lidhen me politikën e vlerësimit, me sistemet e vlerësimit, të praktikave të përdorimit të notave, me vlerësimin e punimeve të nxënësve, me interpretimin dhe raportimin e të dhënave të matjes, me vlerësimin dhe vetëvlerësimin e veprimtarisë së mësuesit.

Qëllimi i Lëndës

Lënda synon të përgatisë studentët për të përmbushur rolin e mësuesit si vlerësues.

OBJEKTIVAT

Në përfundim të kësaj lënde studenti duhet:

- të zotërojë njohuritë për matjen dhe vlerësimin në arsim;
- të jetë i aftë të orientohet drejt në problemet aktuale dhe të perspektivës për matjen dhe vlerësimin në arsim;
- të zotërojë aftësinë për të përzgjedhur instrumentet e matjes dhe të vlerësimit në përshtatje me vendimet mësimore;
- të zotëroje aftësinë për të përpiluar teste;
- të zotërojë aftësinë për të administruar dhe analizuar testet;
- të zotërojë aftësinë për të përdorur instrumentet e vrojtimit të përditshëm;
- të zotërojë aftësinë për të vlerësuar në mënyrë profesionale;
- të zotërojë aftësinë për të interpretuar vlerësimet për nxënësit;
- të zotërojë aftësinë për të regjistruar rezultatet e nxënësve;
- të zotërojë aftësinë për të kryer raportimin e vlerësimeve;
- të jetë i orientuar për t'u përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të vetëvlerësimit në shkollë;

- të demonstrojë qëndrimin e duhur profesional sipas problemeve të vlerësimit;
- të njohë dhe të përdorë sipas çështjeve literaturën e rekomanduar.

Veprimtaritë

Kursi teorik realizohet nëpërmjet **leksioneve**.

Orët praktike përfshijnë:

1. **Seminaret**, të cilat organizohen për çështje të trajtuara në leksion, për çështje të zgjedhura nga literatura dhe nga përvoja shkollore.
2. **Praktikumet**, të cilat organizohen për aftësimin praktik të studentëve në strukturimin e testeve, në përdorimin e procedurave të testimit, të administrimit dhe të analizës së testeve, të vendosjes së notave dhe të përgatitjes së raportimeve, të mbajtjes së qëndrimit të caktuar profesional sipas problemit.

PLANI I ORËVE TEORIKE

Pjesa e parë: Bazat e matjes dhe të vlerësimit

Një hyrje për matjen dhe vlerësimin

- Kuptimi për matjen
- Kuptimi për vlerësimin
- Qëllimet e matjes
- Qëllimet e vlerësimit
- Tendencat e sotme dhe të ardhme për matjen dhe vlerësimin

Planifikimi i matjes dhe vlerësimit

- Përcaktimi i objektivave
- Plani për matjen e një kapitulli
- Nivelet e ndryshme për matjen dhe vlerësimin
- Kufizimet në procesin e matjes dhe të vlerësimit
- Cilësitë e mësuesit për një matje dhe vlerësim të efektshëm

Pjesa e dytë: Teknikat dhe instrumentet e matjes

Testet objektive dhe subjektive

- Testet dhe llojet e tyre
- Testet objektive
 - me përgjigje alternative
 - me alternativa të shumta
 - me kombinime
 - me përgjigje të shkurtër dhe me plotësim
- Testet ese
 - me përgjigje të kufizuar
 - me përgjigje të zgjeruar

Testet e standardizuara dhe testet e përgatitura nga mësuesi

- Përkufizimi dhe klasifikimi i testeve të standardizuara
- Funksionet e testeve të standardizuara
- Tipat e testeve të standardizuara
- Si i interpreton dhe i zbaton mësuesi rezultatet e testeve të standardizuara

Testet e përgatitura nga mësuesi

- Qëllimet dhe funksionet e testeve të përgatitura nga mësuesi

- Parimet kryesore për përgatitjen e testit
- Hapat për përgatitjen e testit
- Administrimi, analiza dhe përmirësimi i testit

Përgatitja dhe përdorimi i mjeteve për vrojtim

- Mjetet për vrojtim
- Përdorimet dhe epërsitë e mjeteve për vrojtim
- Kufizimet e mjeteve për vrojtim
- Përgatitja dhe përdorimi i tipave bazë të mjeteve për vrojtim

Pjesa e tretë: Realizimi i matjes dhe i vlerësimit

Procedura të matjes dhe të vlerësimit

- Procedura e testimit
- Procedura e vlerësimit
 - Politika e vlerësimit
 - Sistemet e vlerësimit
 - Si të vlerësojmë
 - Nota
 - Pjesëmarrja e nxënësve në vlerësim

Vlerësimi i punimeve të nxënësve

- Vlerësimi i testeve objektive
- Vlerësimi i testeve ese
- Vlerësimi i temave
- Vlerësimi i punës në grup
- Vlerësimi i projekteve dhe i demonstrimeve
- Vlerësimi i kompetencës së të folurit

Regjistrimi, interpretimi i të dhënave të matjeve dhe raportimi i vlerësimeve

- Nevoja për procedurat e regjistrimit, të interpretimit dhe të raportimit
- Kriteret që përdoren për regjistrimin, interpretimin dhe raportimin
- Tipat e praktikave të raportimit

Vlerësimi i mësuesit dhe i mësimdhënies

- Kuptimi i vlerësimit, i vetëvlerësimit dhe i reflektimit
- Vlerësimi i mësuesit dhe i mësimdhënies
- Vetëvlerësimi i mësimdhënies

PLANI ORËVE PRAKTIKE

Tema e veprimtarisë

Probleme aktuale të testimit dhe të vlerësimit në shkollën shqiptare

Planifikimi i matjes dhe i vlerësimit

Përgatitja e testeve objektive

Përgatitja e testeve subjektive

Përgatitja e mjeteve për vrojtim

Hartimi i politikës së vlerësimit

Vlerësimi i testeve dhe i punimeve të nxënësve

Probleme të përdorimit të notave

Interpretimi i të dhënave të matjes dhe raportimi i vlerësimeve

Probleme të vlerësimit të mësuesve

Metodologjia e mësimdhënies

Do të përdoren metoda e leksionit, diskutimit, debatit, studimi i rastit, puna në grupe.

Detyrimet e studentit

1. Të marrë pjesë në 80% të orëve mësimore.
2. Nëse do të mungojë në mësim është përgjegjësia e tij të gjejë materialet e shpërndara dhe detyrat e dhëna në atë mësim.
3. Të sigurojë literaturën e rekomanduar për lëndën.
4. Të lexojë paraprakisht literaturën e rekomanduar.
5. Të respektojë idetë e të tjerëve.
6. Të marrë pjesë në mënyrë të efektshme në mësim.
7. Të përmbushë detyrimet e lëndës në afatet e paracaktuara.
8. Të jeni i pranishëm në mësim ditën që ka prezantimin e punimit.

Vlerësimi

Vlerësimi përfundimtar i studentit për këtë lëndë do të bazohet në shumën e pikëve të grumbulluara në orët praktike, në detyrën e kursit dhe në provimin në fund të semestrit. Pikët konvertohen në nota.

1. **Vlerësimi për orët praktike ka 20 pikë dhe përkatësisht i takojnë 2 nota.** Vlerësimi përfshin pjesëmarrjen dhe cilësinë e përmbushjes së objektivave të këtyre orëve. Vlerësimi do të bëhet me shkallëzimin: 20 pikë nga të cilat 8 pikë janë për pjesëmarrjen dhe 12 pikë për cilësinë. Studentët që marrin pjesë në 80% të orëve fitojnë 8 pikët e pjesëmarrjes, të tjetër nuk i fitojnë. Cilësia do të matet me përmbushjen e kërkesave të detyrave për orët praktike.
2. **Detyra e kursit është individuale dhe e detyrueshme për çdo student. Vlerësimi i detyrës së kursit bëhet me 20 pikë dhe i takojë përkatësisht 2 nota.** Si detyrë kursi do të pranohet një studim rasti për një çështje të vlerësimit të nxënësit.

Udhëzim për përgatitjen e detyrës së kursit

Studim rasti

Me anë të studimit të rastit hulumtohet, studiohet me hollësi një rast, situatë e veçantë, një vendim, një ngjarje ose një çështje. Studimi i rastit nënkupton një studim intensiv të një teme për një periudhë kohe të shkurtër. Kjo teknikë mundëson që të mblidhet informacion i hollësishëm që nuk mund të mblidhet me teknika të tjera.

Formati i studimit të rastit duhet të përmbajë këto elemente:

- a. Titulli i studimit të rastit.
- b. Hyrje që përshkruan çështjen duke iu referuar literaturës (2 faqe).
- c. Përshkrim i rastit konkret që është marrë në studim (1 faqe).
- d. Evidencë për rastin: fakte, probleme, konflikte, dokumente mbështetëse (2 faqe).
- e. Analizë e evidencës së rastit (4 faqe).
- f. Rekomandime për zgjidhjen e çështjes ose ndikimin e saj për sistemin ose shkollën (1 faqe).

g. Referenca (5-10 burime)

Punimi duhet të jetë 10 faqe të shtypura në kompjuter me spacio 1, me shkrim Times New Roman me madhësi të shkronjave 12. Punimi dorëzohet javën e fundit të semestrit.

Punimi do të vlerësohet sipas përmbushjes së kriterëve të mëposhtme:

- të vlerësojë në mënyrë kritike mendimin brenda çështjes së zgjedhur duke demonstruar njohuritë dhe përvojën që zotëron studenti;
- të demonstrojë një vetëdije profesionale në trajtimin e çështjes së zgjedhur;
- të reflektojë qëndrimin dhe rekomandimet origjinale të autorit;
- të reprojektojë kërkesat e formatit të punimit.

Temat për detyrën e kursit

- Përdorimi i testeve për vlerësimin e nxënësve në mësimin e gjuhëve të huaja
- Përdorimi i dosjes së nxënësit në gjuhët e huaja
- Evidencat e vlerësimit
- Përdorimi i notës në gjuhët e huaja
- Vlerësimi i eseve në gjuhë të huaj
- Provimi me zgjedhje në gjuhë të huaj
- Politika e vlerësimit të nxënësve
- Konflikti mësues-nxënës për shkak të vlerësimit

3. Provimi zhvillohet me shkrim në fund të semestrit. Testi vlerësohet me 60 pikë dhe përkatësisht me 6 nota.

Literatura

1. Bachman F. Lyle: Fundamental Consideration in Language Testing. Oxford University Press, 1990. (Ndodhet në British Resource Centre, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja)
2. Callahan, F. Joseph & Clark, H. Leonard: Teaching in the Middle and Secondary Schools, Planning for Competence, Third Edition, Macmillan Publishing Company, USA, 1988, p. 337-365, 366-401. (Ndodhet në Bibliotekën e FSHS)
3. The International Encyclopedia of Educational Evaluation, Pergamon, 1992, p.7-15, 29-31, 42-47, 61-67, 89-106, 145-147, 418-420, 420-428, 428-433, 508-510, 745-751.
4. International Encyclopedia of Teaching and Teacher Education, Second Edition, Pergamon, 1995, p.290-295, 299-305.
5. Metoda të mësimdhënies, Tiranë, 1999. (Ndodhet në FSHS)
6. Mita, Nikoleta: Vlerësimi i nxënësit, Tiranë 2009.
7. Nitko, J. Anthony: Educational Assessment of Students, Second Edition, New Jersey, 1996.

5.MENAXHIMI I KLASËS

Hyrje

Kapitulli 1:“Parandalimi i sjelljeve problematike” fokusohet në sjelljet e papershtatshme të nxënësve që shkaktohen nga shumë faktore. Këta faktore që shkaktojnë sjelljen antisociale janë identifikuar si në shtepi ashtu edhe në shkollë:

nje mjedis ndeshkues, mungesa e pasojave pozitive dhe paqendrueshmerite në vendosjen e rregullave dhe në zbatimin e pasojave.

Te gjithë keto sebashku me mungesën e vetedijshmerisë ndaj ndryshimeve individuale të nxenesve, përfshirë ato që lidhen me etninë, mund të çojnë në ndeshkim të papershtatshëm të sjelljeve problematike.

Kapitulli 2: "Organizimi dhe menaxhimi i klases" vë theksin në vendosjen rutine në klase dhe organizimit të ambientit fizik. Në këtë kapitull paraqitet një model në të cilin masat ndeshkimore përdoren për shkelje të mëdha. Ky model parandalues shërben për të krijuar ambiente të sigurta në shkollë, që përjashtojnë përdorimin e dhunës dhe që ndeshkojnë të mesuarit.

Kapitulli 3: "Përforsuesit, vlerësimi, shpërblimet dhe motivimi" paraqet një sërë përforsuesish të mundshëm të cilët është e dobishme që të identifikohen dhe të përdoren për zëvendësimin e sjelljes problematike me sjelljen e dëshiruar.

Kapitulli 4: "Strategjitë e mesimdhënies" trajton nevojat e ndryshme të nxenesve për të përdorur një sërë strategjish të mesimdhënies, përdorimi i të cilave ndihmon si në parandalimin e dështimeve mësimore ashtu dhe të sjelljeve problematike.

Kapitulli 5: "Përfshirja e prindërve në edukim" pohon se përfshirja e prindërve është çelsi për të ndihmuar fëmijet të jenë të suksesshëm në shkollë. Ata behen me të mirë atëherë kur prindërit e tyre kujdesen rreth asaj që ata janë duke bërë në shtëpi, në komunitet dhe në shkollë.

Kapitulli "Aktivitetet e menaxhimit të klases" është një kapitull i ndërtuar mbi bazën e aktiviteteve praktike përkthyer në aktivitete pozitive të menaxhimit të klases, të cilat mund të përdoren për të krijuar një ambient pozitiv.

Mesazhi kryesor që përcjellin këto strategji është që nxënësit të mesohen si të sillen dhe jo të ndeshkohen apo të mesohen sesi të mos sillen. Gjithashtu përkthyer edhe programe që mund të përdoren për të mesuar moshataret të vlerësojnë njëri – tjetrin në mënyrë pozitive.

Kapitulli 6: "Vlerësimi i sjelljes dhe nderhyrjet lidhur me të në klase" si dhe "Sjelljet agresive" vë në dukje avantazhet e vlerësimeve të sjelljeve që kanë të bëjnë me faktin se ato çojnë në ndryshime afatgjata të sjelljeve të nxenesve.

Tek "Sjelljet agresive" përkthyer në dy procedura ndeshkuese për të trajtuar agresivitetin e nxenesve, "koha bosh" dhe "gjobat", të cilat duhet të përdoren me kujdes dhe duhet të kombinohen me alternative konstruktive për të maksimizuar suksesin e tyre në reduktimin e sjelljeve agresive.

II. Qëllimi i përgjithshëm i programit.

Si pjesë përberëse e modulit të papercaktuar kjo lende, pra programi i saj synon:

1. Orientimin në shkencën e psikologjisë së zbatuar në mesimdhënie, për të njohur dhe përvetësuar, konceptet, metodologjinë që i duhen një mesuesi për të menaxhuar klasën.
2. Të përcaktojë rëndësinë dhe vendin që zë në përgatitjen e mesuesit kjo fushë e psikologjisë së zbatuar në mesimdhënie, në parandalimin e sjelljeve problematike, organizimin dhe menaxhimin e klases, motivimin si dhe vlerësimin e sjelljes së nxënësit.

III. Objektivat e programit

Realizimi i këtij programi synon aftësimin e studentëve për:

1. Zotërimin e principeve, koncepteve baze të mesimit të lëndës "Psikologji e zbatuar në mesimdhënie".
2. Të jetë i aftë të zgjidhë në mënyrë krijuese situatat konkrete të nxenesve në mesim si dhe të krijojë një klimë pozitive në klase gjatë procesit të mesimdhënies.

Studentet do ti realizojne keto objektiva nepermjet njohjes, studimit dhe diskutimit te informacioneve, nepermjet pjesmarrjes se tyre ne oret e leksioneve dhe te seminareve, studimit individual, puneve te pavarura si dhe puneve ne grupe.

IV. Veprimtarite ne zbatimin e programit.

1. Kursi teorik realizohet nepermjet oreve te mesimeve, sipas nje tematike ne ceshtjet kryesore te cilat kane vlera formuese.
2. Oret praktike ne te cilat perfshihen:
 - Diskutimi i ceshtjeve te trajtuara ne auditor.
 - Ushtrime praktike, mikrodetyra per situata te ndryshme persa i perket menaxhimit te klases.
 - Testime per te matur dhe vleresuar dijet e fituara.

V. Vleresimi perfundimtar.

Lenda "Psikologji e zbatuar ne mesimdhenie" ne vleresimin perfundimtar merr ne konsiderate:

- shlyrjen e detyrimeve qe permban programi i lendes
- provimi ne fund te semestrit.

IV. Permbajtja analitike e kursit

Parandalimi i sjelljeve problematike.

- Trajtimi i deshtimeve te nxenesve ne punen mesimore.
- Pervetesimi i shprehive sociale.
 - Percaktimi i rregullave dhe disipline.
- Perdorimi i procedurave te pershtatshme per menaxhimin e sjelljes.

Organizimi dhe menaxhimi i klases"

- Ambjenti fizik. Rutina dhe procedurat ne klase
- Rregullorja e klases.
- Si te behet menaxhimi i sjelljes se nxenesve.
 - Trajtimi i shqetesimeve

Perfocuesit, vleresimi, shperblimet dhe motivimi.

- Identifikimi i perforcuesve per nxenesit qe motivohen me veshtiresi
- Perfshirja e prinderve / kujdestareve ne programe motivuese.
- Maksimizimi i efektivitetit te programeve motivuese.

Strategjite e mesimdhenies".

- Perzgjedhja e strategjive er mesimdhenie
- Vetemenaxhimi i shprehive tete mesuarit.
- Strategji te tjera te mesimdhenies.

Perfshirja e prinderve ne edukim".

- Formimi i partneritetit shkolle – familje.
- Perfshirja e prinderve ne detyrat e shtepise.
- Komunikimi shkolle – familje.
- Vizitat ne shtepi.

Vleresimi i sjelljes dhe nderhyrjet".

- Metoda e ndeshkimit.

- Vleresimi per te percaktuar shkaqet e sjelljeve problematike
 - Perzgjedhja e nderhyrjeve qe bazohet ne funksionin e sjelljes.
 - Shperblimet materiale

Sjelljet agresive”

- Strategjite per parandalimin dhe uljen e agresivitetit.
 - Strategjite per t’u perballur me sjellje agresive / dhune.
- Llojet e sjelljeve agresive.

Sjellje te tjera problematike”.

- Probleme te ndjekjes se shkolles
- Abuzimi me substancat

VII. Plani tematik i seminareve.

1. Orientimet e pergjithshme per seminarete.
 - Pikesynimet, detyrat dhe kerkesat per seminarete.
 - Njohja me programin e lendes dhe permbajtja e seminareve.
 - Kerkesa dhe udhezime per pergatitjen e mikrodetyrave me karakter praktik, te cilat do te jene te nderthurura me temat e seminareve te meposhtme.
2. Parandalimi i sjelljeve problematike
3. Modelet dhe aktivitetet me te pershtatashme qe ndihmojne per te krijuar ambjente te sigurta ne shkolle si dhe mesimin e shprehive sociale.
4. Perforcuesit dhe llojet e tyre qe mund te perdoren per te rritur motivimin e nxenesit per te mesuar dhe per tu sjelle ne menyre te pershtatshme ne klase.
5. Strategjite e mesimdhenies.
6. Krijimi i nje partneriteti mes shkolles dhe familjes.
7. Vleresimi i sjelljeve normale dhe atyre agresive si dhe nderhyrjet lidhur me te ne ambjentin shkollor.

6.ZHVILLIMI I KURRIKULËS

I.Hyrje

Një nga elementet e rëndësishëm të formimit të mësuesve është njohja më kurrikulat dhe procesin e zhvillimit të tyre. Formimi i mësuesve ka nevojë të plotësohet edhe me njohuri për dhe e elementet e kurrikulën si: Planet mësimore, programet mësimore, tekstet shkollore, parimet e ndërtimit të tyre, vlerësimin e kurrikulës, zhvillimin profesional të mësuesit, mbrojtjen e fëmijëve, si dhe planifikimin e orës së mësimin.

Në këtë vështrim, edhe kursi i kësaj lënde hedh dritë mbi aspektet themelore të kurrikulës, si dhe planifikimin e orës së mësimin. Të gjitha këto janë pjesë e përgatitjes profesionale të mësuesve të rinj. Programi i studimit të lëndës synon t’u vijë në ndihmë studentëve për t’u njohur me qëllimet, objektivat dhe përmbajtjen e kursit. Gjithashtu, studentët njihen me grafikun e mësimeve të ndara për çdo javë, detyrimet që studenti ka për të shlyer gjatë gjithë periudhës së studimit, mënyrën e vlerësimit dhe literaturën e nevojshme.

II.Qëllimet e kursit janë:

Qëllimi i kursit “Zhvillimi i kurrikulës dhe planifikimi i mësimi”, është:

- Të angazhojë mendjet e studentëve në kërkim.
- Marrja e njohurive bazë rreth zhvillimit të kurrikulës parimeve, bazave, strukturës dhe tendencave të zhvillimit të kurrikulës.
- Të njohin dhe të aftësohen studentët për zhvillimin dhe mbrojtjen e të drejtave fëmijëve.
- Aftësimi i studentëve për vlerësimin e kurrikulës.
- Njohja dhe aftësimi me procedurat e planifikimit të mësimi.

III.Objektivat e kursit

- Krijimi i vizionit të qartë mbi parimet e ndërtimit të kurrikulës
 - Krijimi i bindjeve për nevojën e zhvillimit të kurrikulës.
 - Debatimi rreth risive që ndodhin në zhvillimin e kurrikulës, kurrikulat moderne e postmoderne, si dhe për planifikimin e orës së mësimi.
 - Dhënia e kontributit në përmirësimin e kurrikulës dhe planifikimin e mësimi.
 - Të aftësohen për vlerësimin e të gjithë elementeve të kurrikulës.
 - Të njohin dhe të aftësohen studentët për promovimin, menaxhimin dhe mbrojtjen zhvillimin dhe mbrojtjen e të drejtave fëmijëve.

IV.Përmbajtja e kursit

1. Fusha e kurrikulës, metodat e kurrikulës
2. Parimet e ndërtimit të kurrikulës
3. Metodot teknike e shkencore dhe jotechnike joshkencore të kurrikulës
4. Hartimi i kurrikulës. Modelet përfaqësuese të kurrikulës
5. Qëllimi, synimi dhe objektivat. Nivelet klasifikuese të objektivave arsimorë
6. Planet mësimore, programet mësimore. Tekstet shkollore. Procesi i hartimit të tyre.
7. Kurrikula dhe shoqëria
8. Përmirësimi i kurrikulës
9. Zbatimi i kurrikulës
10. Vlerësimi i kurrikulës
11. Mësuesit dhe zhvillimi profesional. Planifikimi vjetor i mësimi
12. Kurrikula plotësuese, Probleme të reja për nxënësit “në rrezik”. Identifikimi i fëmijëve në rrezik. Abuzimi. Fëmijët me aftësi të kufizuara dhe abuzimi. Dhuna në familje.
13. Kurrikula dhe Mbrojtja e fëmijëve në shkolla. Konventa mbi të drejtat e fëmijës. Aktorët dhe përgjegjësitë në rrjetin e mbrojtjes së fëmijëve në shkolla, politika e mbrojtjes së fëmijëve në shkolla dhe standardet e shkollës për mbrojtjen e fëmijëve.
14. Arsimi shumëkulturore, Arsimi për të gjithë nxënësit. Grupet e reja në vështirësi edukimi dhe mbrojtja e tyre. Komunikimi. Mjedisi miqësor me fëmijët.
15. Prindërit dhe komuniteti si partnerë në edukim dhe në mbrojtjen e fëmijëve.

V.Grafiku i mësimi në javë

Lënda do të zhvillohet me dy orë leksion në javë dhe një orë seminar.

I. Detyrimet e studentit

- a. Pjesëmarrje në leksione dhe frekuentim aktiv në seminare. Vlerësim për pjesëmarrjen në seminare. Kjo i jep mundësi studentit të marrë 0% deri në 10% të notës përfundimtare.
- b. Gjatë kursit studentët punojnë individualisht për realizimi i një detyre kursi. Në fund të semestrit detyrat referohen. Detyra e kursit i jep mundësi studentit të marrë 0% deri në 20% të notës përfundimtare.
- c. Testimi përfundimtar. Në përfundim të kursit dhe pas shlyerjes së detyrimeve të njohura më parë, studenti i nënshtrohet provimit përfundimtar me shkrim në formë testi. Provim me shkrim i detyrueshëm, i cili do të bazohet në pyetje të hapura dhe të mbyllura mbi temat e trajtuara gjatë leksioneve. Dhënia e provimit me shkrim i jep mundësi studentit të marrë 0% deri në 70% të notës përfundimtare.

Totali 100 pikë

VI.Orë konsultimi:

Orët e konsultimit janë një here ne jave pranë Departamentit të Psikologji/Pedagogji, mbas orëve të leksionit. Ora dhe dita e konsultimit do të caktohet gjatë javës.

VII.Vlerësimi.

Vlerësimi i studentëve në lëndën “Zhvillimi i kurrikulës”, bëhet mbi bazën e tre komponentëve që u përmendën më sipër dhe kjo do të shprehet formalisht në formë pikëzimi për secilin komponent.

VIII.Literatura.

Kurrikula bazat, parimet dhe problemet. Autorë: Allan C. Orstein, Francis P. Hunkins

Mësimdhënia dhe të nxënit. Autorë: A. Tamo. Th. Karaj, E. Rapti.

Manuali i Mbrojtjes së Fëmijëve për shkolla, Botim i “Terre des Hommes”.

Mbrojtja e Fëmijëve – Udhëzuesi Praktik për profesionistët që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve. Botim i “Terre des Hommes”.

XI. Literaturë plotësuese:

Making the curriculum work. Botim i “Centre for educational research and innovation”.

www.mash.gov.al Drejtoria e Kurrikulës

7.PSIKOLINGUISTIKE DHE METODOLOGJI E GJUHES SE HUAJ

Objektivat e lëndës

PJESA I

Kursi synon të japë njohuri për lidhjen e gjuhës me psikologjinë dhe faktorët që ndikojnë në kuptimin dhe në shprehjen e gjuhës me gojë dhe shkrim. Thellohen njohuritë mbi lidhjen e gjuhës me mendimin dhe kujtesën dhe mënyrat e trajtimit të problemeve të ndryshme që ndeshen gjatë mësimit të gjuhës së huaj.

PJESA II

Kursi synon të pajisë studentët me njohuri teorike dhe shprehi praktike për mësimin e gjuhës italiane në shkollën e mesme, në përputhje me veçoritë psikologjike të moshës. Vëmëndja përqëndrohet në përdorimin e metodave dhe teknikave të tilla që sigurojnë përvetsim aktiv të aftësive komunikative të gjuhës , ndertim dhe perdorim te formave efektive te testimit, vleresimit dhe vetvleresimit si dhe përdorim të mjeteve audovizive ne perputhje me qellimet mesimore.

Përshkrimi i programit

Pjesa I

- Njohja me shkencën e psikolinguistikës.
- Mësimi i gjuhës amtare nga fëmijët dhe të rriturit.
- Gjuha dhe mendimi
- Gjuha dhe kujtesa
- Gjuha dhe kultura
- Studimi i fjalëve dhe mësimi i tyre
- Fjalja, kuptimi i saj dhe trajtimi i dykuptimeve
- Biseda, prodhimi i të folurit
- Bilingualizmi
- Përvetsimi i gjuhës së huaj
- Leximi dhe parimet e tij
- Shkrimi dhe ndikimi i tij në të lexuarit
- Teoritë mbi përvetsimin e gjuhës.
- Metodatat e mësimin të gjuhës së huaj

Pjesa II

- Paraqitja dhe praktikimi i fjalorit.
- Përvetsimi dhe zgjerimi i fjalorit nëpërmjet leximit
- Paraqitja dhe praktikimi i gramatikës në lidhje me kontekstin .
- Organizimi i punës gojore në klasë, individualisht dhe në grupe.
- Mësimi dhe praktikimi i katër aftësive të komunikimit.
- Zgjedhja e materialit mësimor në përputhje me moshën. (Këngët, përrallat, fabulat)
- Lojrat gjuhësore.
- Zgjedhja, shfrytëzimi dhe zbërthimi i teksteve në gjuhën e huaj.
- Drejtimi i klasës dhe organizimi i punës në çifte dhe në grupe.
- Gabimet dhe trajtimi i tyre
- Detyrat e shtëpisë, puna me fjalorin dhe punë krijuese në grup.
- Plani vjetor dhe ditor
- Vlerësimi në procesin e mësimin të gjuhëve të huaja. Objektivat dhe funksionet e vlerësimit
 - Tipet e teknikat e vlerësimit
- Përcaktimi i objektivave dhe ndërtimi i testeve për çdo aftësi komunikimi
- Vetëvlerësimi
- Testet e vlerësimit

Literatura

Cikël leksionesh përgatitur nga pedagogët e lëndës.

Common European Framework of Reference for Languages: Learning, teaching, assessment. Cambridge University Press 2003.

G. Freddi, La psicolinguistica, la sociolinguistica e la glottodidattica 1999.

Gabriele Pallotti: La seconda Lingua

Jean Berko Gleason & Nan Bernstein Ratner, Psycholinguistics, 1993, Harcourt Brace Johanovich College Publishers

Leopold, W. Semantic Learning in Infant Language.

Mazzotta, P. L'insegnamento delle lingue nella scuola di base.

Moerk, E. 1989, Journal of the Experimental Analysis of Behavior .

R. Titone, La psicolinguistica oggi.

Metoda didaktike e mësimdhënies

Leksione, Seminare, Projekte

Mënyra e vlerësimit

Vlerësim I vazhdueshëm 20 %, prezantim 30%, provim perfundimtar 50%

8. GJUHESI E ZBATUAR DHE KOMUNIKIM NDERKULTUROR

Objektivat e lëndës

Pjesa I

Gjuhësi e zbatuar

-Aftësimin e studenteve për zbatimin praktik të njohurive në fushën e gjuhësisë

-Pajisjen e tyre me shprehje për mesimdhënien e fonetikes, gramatikes dhe leksikologjisë

-Identifikimi i tipareve të përbashkëta, i tipareve pjesërisht të përbashkëta dhe i tipareve të ndryshme në Gjuhën Shqipe dhe në Gjuhën italiane.

-Shmangia e gabimeve në fushën e mësimdhënies së Gjuhës italiane për shqiptarët dhe të Gjuhës Shqipes për italishtfolësit, si dhe në fushën e përkthimit nga gjuha italiane në gjuhën shqipe dhe anasjelltas.

Pjesa II

“**Didaktikë e letërsisë dhe e qytetërimit**” synon të sensibilizojë studentët në fushën e mësimdhënies së kulturës gjatë procesit të mësimdhënies së gjuhës italiane si gjuhë e huaj. Përçimi tek studenti i qytetërimit dhe kulturës së gjuhës që studion nga pikëpamja historike, sociologjike dhe etnografike. Ai synon që mësuesi i ardhshëm të kuptojë rëndësinë e kulturës dhe letërsisë në mësimin e gjuhës së huaj, të fitojë aftësi për mësimin e gjuhës italiane nëpërmjet letërsisë, të zhvillojë aftësi për trajtimin e informacionit dhe argumenteve në mënyrë kritike dhe vetë reflektuese, me qëllim respektimin e kulturës shqiptare dhe vlerësimin e respektin e kulturës së huaj. Përdorimi i teksteve letrare dhe dokumenteve të tjerë autentike do bëhet në mënyrë të tillë që të rrisë zotërimin e katër aftësive themelore të komunikimit: dëgjimin, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit dhe të krijojë portofolin letrar të mësimin të gjuhës dhe të ndërveprimit ndërkulturor.

Përshkrimi i programit

Pjesa I

Roli i gjuhësisë në mësimdhënien e gjuhës së huaj dhe lidhja midis njohurive, teorise dhe praktikës së gjuhës.

Fushat e gjuhësisë së aplikuar, çështjet e mësimdhënies së tyre në gjuhën e huaj

- Studimi gjuhësor dhe fushat e tij të zbatimit
- Teoritë gramatike dhe përdorimi i tyre në mësimdhënien e gjuhës së huaj.
- Analizimi i gabimeve
- Dimensione gjuhësore të planifikimit të një metode gjuhe.
- Konceptet themelore të analizës së ligjëratës.
- Teknika për trajtimin e fjalorit dhe mësimnxënja dhe mësimdhënja e fjalorit
- Fjalori në kontekst, ndertimi i fjalëve dhe fjalori kyç.
- Adaptimi i materialit për mësimin e fjalorit.
- Mësimdhënja e gramatikës në mënyrë sistematike.
- Emrat; Mbiemret; Përemrat; Foljet; Ndajfoljet; Parafjalët; Lidhëzat; Togfjalëshat; Fjalitë; Periudha; Ligjëratat e drejtë, të zhdrejta dhe të zhdrejta të irl.

Pjesa II

Çështjet kryesore:

1. Roli i kulturës në mësimin dhe nxënien e gjuhës së huaj:
 - 1.1. Binomi i pandashëm Gjuhë – Kulturë;
 - 1.2. Nxënia e kulturës: akulturimi, shoku kulturor, ndryshimet sociale;
 - 1.3. Vendi dhe roli i kulturës në mësimdhënien e gjuhës së huaj.
2. Edukimi ndërkulturor në mësimdhënien e gjuhës italiane si gjuhë e huaj.
 - 2.1. Krijimi i stereotipeve dhe ndërtimi i sociotipeve;
 - 2.2. "Vështirësitë" ndërkulturore, grupimi sipas karakteristikave socio-karakteriale;
 - 2.3. Raporti mes gjuhës së huaj, kulturës e stileve konjiktive në kontekstin shkollor;
 - 2.4. Kultura e origjinës dhe ndikimi i saj në stilin e nxënies së njohurive të një fëmije/të riu.
3. Didaktika e gjuhës në perspektivën ndërkulturore
 - 3.1. Objektiva dhe qëllime të didaktikës në perspektivën ndërkulturore;
 - 3.2. Kompetencat komunikative ndërkulturore dhe implementimi i tyre në procesin didaktik;
 - 3.3. Rendi i fjalëve dhe regjistri gjuhësor; Zhvillimi i kompetencave të gjesteve; incidentet ndërkulturore.
4. Didaktizimi i materialit autentik
 - 4.1. Kuptimi mbi "materialin autentik"; tipologjia e materialeve autentike;
 - 4.2. Didaktizimi i materialit autentik;
 - 4.3. Fazat e njësive didaktike në didaktizimin e materialit autentik.
5. Letërsia në kontekstin jashtëshkollor dhe shkollor:
 - 5.1. Çfarë është letërsia; qëllimi dhe arsyet e përdorimit të letërsisë në mësimin e gjuhës së huaj;
 - 5.2. Probleme dhe zgjidhje të mundshme gjatë përdorimit të letërsisë në mësimin e gjuhës së huaj.
6. Komunikimi dhe letërsia:
 - 6.1. Kompetenca komunikuese; raporti mes gjuhës, letërsisë dhe kontekstit;

- 6.2. Konteksti dhe nivelet e kuptimit: SPEAKING;
- 6.3. Shtresëzimet e kontekstit dhe “teatri i lexuesit”;
- 6.4. Raporti mes gjuhës, letërsisë dhe lexuesit. Gjuha letrare dhe karakteri letrar i një teksti. Historia e letërsisë si një hipertekst kulturor.
- 7. Raporti mes letërsisë, shkrimit dhe leximit: ndryshoret e komunikimit:
 - 7.1. Karakteristika të veçanta;
 - 7.2. Zgjedhjet morfo-sintaksore e leksikore;
 - 7.3. Raportit mes tekstit dhe lexuesit: negocimi i kuptimit;
 - 7.4. Raportit mes tekstit dhe njohurive për botën;
 - 7.5. Përvoja tekstore të mëparshme;
 - 7.6. Nënkuptimet e tekstit.
- 8. Letërsia: mes komunikimit dhe interpretimit:
 - 8.1. Përzgjedhja dhe vlerësimi i materialeve;
 - 8.2. Reagimi i lexuesit dhe puna përgatitore e mësuesit;
 - 8.3. Teknika didaktike për përdorimin e letërsisë në mësimin e gjuhës së huaj: para leximit; leximi i parë në klasë; aktivitete gjatë leximit; mbas leximit;
 - 8.4. Një modalitet alternativ: “leximi me brezare”.
- 9. Letërsia në kontekste specifike:
 - 9.1. Letërsia në didaktikën e gjuhës italiane për fëmijë; aspekte glotodidaktike; modele operative: nxënësi deri në 10 vjeç; nxënësi 11 - 18 vjeç;
 - 9.2. Letërsia në didaktikën e gjuhës italiane për të rritur; aspekte glotodidaktike; modele operative.
- 10. Mësimi i gjuhës dhe i kulturës italiane nëpërmjet këngës:
 - 10.1. Avantazhe dhe disavantazhe në përdorimin e këngës.
- 11. Kultura italiane nëpërmjet këngës së muzikës së lehtë dhe këngës rap:
 - 11.1. Promovimi i edukimit ndërkulturor nëpërmjet këngës së muzikës së lehtë;
 - 11.2. Letërsia nëpërmjet këngëve të muzikës së lehtë.
- 12. Përdorimi i këngës si dokument artistik, historik dhe i zakoneve italiane në mësimin e gjuhës italiane:
 - 12.1. Motivimet e zgjedhjes së këngës së muzikës së lehtë dhe asaj rap;
 - 12.2. Analiza tekstore e këngës së muzikës së lehtë dhe asaj rap.
- 13. Audiovizivët, situata audiovizive; format e audiovizivëve, gjuha e tyre:
 - 13.1. Audiovizivët në jetën e përditshme; Qasja komunikativo-formative; Q.C.R.E.; situata audiovizive e elementët e saj; vizioni kompleks; kinemaja;
 - 13.2. *Media Education*: Avantazhe e dizavantazhe;
 - 13.3. Suportet dhe formatet e videos; format audiovizive më të përhapura;
 - 13.4. Imazhi, tingulli, performanca, gjuha audiovizive, raporti mes tingujve e imazheve.
- 14. Disa implikime glotodidaktike në përdorimin e audiovizivëve në klasë:
 - 14.1. Zbatimi i *Expectancy Grammar* i Oller-it; memorizimi; respektimi i parimit të Danezit; prezantimi i gjuhës autentike; zhvillimi i aftësive receptuese dhe krijuese; vështirësitë e kuptimit të audiovizivit;
 - 14.2. Përdorimi, seleksionimi, prezantimi, didaktizimi e krijimi i një audiovizivi (*self-media*).
- 15. Lidhja mes kulturave dhe inteligjencave:
 - 15.1. Kultura dhe inteligjencat: Inteligjenca gjuhësore, muzikore, kinestetiko-trupore, logjiko-matematikore, hapësinore, ndërpersonale dhe personale;
 - 15.2. Didaktika e projekteve për të mësuar dhe bashkëpunuar.

Rezultatet e pritshme.

Në fund të kursit studentët do jenë të pajisur me:

1. metodologjinë dhe mjetet e duhura për ta kthyer civilizimin dhe letërsinë italiane në objekt të mësimdhënies së gjuhës;
2. teknika të mësimdhënies që synojnë mësimin e gjuhës, por edhe mësimin nëpërmjet gjuhës me qëllim që të përgatisin qytetarë të denjë të botës;
3. njohuri bazë të dimensionit ndërkulturor të mësimin të gjuhës së huaj;
4. një pikëpamje më kritike dhe të ndërgjegjshme të rolit të kulturës në gjuhë dhe vështirësitë ndërkulturore që hasen gjatë procesit të mësimin dhe nxënies së gjuhës së huaj;
5. njohje të qëllimeve të didaktikës së gjuhës në perspektivën ndërkulturore;
6. stimuj për zhvillimin dhe përfundimin e dimensionit ndërkulturor të studentëve me qëllim implementimin e tij në procesin didaktik të përditshëm.

Bibliografia

- K.Dibra, Elementi di Fonetica e Fonologia italiana, SHBLU
- L.Renzi, Grande Grammatica italiana di Consultazione (Vol. I dhe II), Utet
- Materiale të ndryshme nga interneti për të mbështetur temat e zhvilluara.
- K. Dibra, Cikël leksionesh përgatitur nga titullari i lëndës.
- Armellini, G. (1987), *Come e perché insegnare letteratura*, Bologna, Zanichelli.
- Balboni, P.E. (1998), *Tecniche didattiche per l'educazione linguistica*, Torino, Utet.
- Balboni, P.E. (1999), *Parole comuni, culture diverse. Guida alla comunicazione interculturale*, ed. Marsilio, Venecia.
- Balboni, P.E. (2002), *Le sfide di Babele. Insegnare le lingue nelle società complesse*, Torino, Utet.
- Balboni, P.E. (2004), (a cura di) *Educazione letteraria e nuove tecnologie*, Torino, UTET
- Balboni, P.E. (2007), *La comunicazione interculturale*. Marsilio, Venecia
- Balboni, P.E., Luise M.C., (1994), *Interdisciplinarietà e continuità nell'educazione linguistica*, Roma, Armando.
- Bruner, J. (1996), *La cultura nell'educazione*, Milano, Feltrinelli.
- Caon, F., (2007), *L'uso delle canzoni come documento di lingua, cultura e letteratura*, Materiali per i corsi FILIM.
- Celentin, P., Serragiotto, G. (2000), *Il fattore interculturale nell'insegnamento della lingua*, në Dolci, R., Celentin, P., *La formazione di base del docente di italiano per stranieri*, Bonacci editore, Roma
- Lama, I, Cikël leksionesh përgatitur nga titullaria e lëndës.
- Lavinio, C. (1990), *Teoria e didattica dei testi*, Firenze, La Nuova Italia
- M. Mezzadri (2003), *Lingua e cultura*, në *I ferri del mestiere*, Guerra Soleil, Peruxhia.
- Pavan, E. (2003), *La cultura e la civiltà italiane e il loro insegnamento in una prospettiva interculturale*, në Dolci, R., Celentin, P. (Edizioni 2°) *La formazione di base del docente di italiano per stranieri*, Bonacci editore, Roma;
- Stagi Scarpa, M. (2005), *Insegnare letteratura in lingua straniera*, Roma, Carrocci.

Metoda didaktike e mësimdhënies

Leksione , seminare

Mënyra e vlerësimit

Detyra kursi (puna praktike); pjesëmarrje aktive; Provimi përfundimtar .

9.BURIME TE INFORMACIONIT NE MESIMIN E GJUHES SE HUAJ

Objektivat e kursit:

Ky kurs u mundëson studentëve:

- Informacion/botëkuptim të përgjithshëm të proceseve, praktikave dhe efekteve të përfshirjes së teknologjive në procesin e mësimdhënies dhe kryesisht atë të mësimit të gjuhëve të huaja. Zhvillimin e pikëpamjeve pozitive përsa i përket përdorimit të teknologjive në mbështetje të të mësuarit gjatë gjithë jetës,
- Praktikim në përdorimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe programeve përkatëse në aspektin e mësimdhënies së gjuhës së huaj.
- Vlerësim kritik të materialeve duke i familjarizuar studentët me mënyrat për të kërkuar burimet e duhura. Aftësimin e tyre për vlerësimin dhe zhvillimin e materialeve për klasën

Pershkrimi i programit:

- Piramida e teknologjisë – Koncepte të përgjithshme
- Zhvillimi i aftësive kërkimore dhe gjuhësore nëpërmjet përdorimit të teknologjisë
- Teksti mësimor dhe kompjuteri
- Mënyra të përdorimit të mjeteve shtesë si tabelës, projektorit, kasetave audio dhe video, etj.
- Si të praktikojmë gjuhën më anë të internetit dhe CD- ROM
- Forma të reja të komunikimit që transformojnë të mësuarit dhe të nxënit; Forume, Blog-e, Ditare (Journals)
- Ofrimi i kulturave duke përdorur teknologjinë
- Mënyrat e ndryshme të lidhjeve në internet
- Krijimi i një faqe interneti për studentët – projekte krijuese
- Përdorimi i bazave të të dhënave në klasë dhe jashtë saj
- Mjetet Vizive, audio dhe multimedia – pse duhen përdorur ato në mësimdhënie
- Përgatitja e materialeve mësimore në përshtatje me nivelin e klasës
- Adaptimi dhe plotësimi i teksteve shkollore me materiale të marra nga burimet teknologjike të informacionit

Literatura:

- D. Parisi, *Scuola.it. Come il computer cambierà il modo di studiare dei nostri figli*, Milano, Mondadori, 2000.
- F. Cremascoli e M. Gualdoni, *La lavagna elettronica. Guida all'insegnamento multimediale*, Laterza, Bari, 2000.
- A. Amitrani, R. Di Marzio *Un computer per Amico Percorsi multimediali nella scuola del 2000*, Roma, Garamond 2000.
- P. Stoppelli, E. Picchi (a cura di), *LIZ Letteratura Italiana Zanichelli 4.0*, Bologna, Zanichelli, 2001

<http://www.4teachers.org>

<http://www.teach-nology.com>

Cikël leksionesh të përgatitura nga titullari i lëndës

Metoda didaktike

Leksione, seminare dhe detyra praktike në klasë dhe individualisht.

Mënyra e vlerësimit

Detyra praktike gjatë modulit dhe provim në fund të tij.

10.MESIMI I GJUHEVE TE HUAJA PER QELIME SPECIFIKE

Objektivat e lëndës

Kjo lëndë synon të pajisë studentëve me njohuri të përshtatshme teorike dhe shprehje praktike për ndërtimin e programeve dhe mësimdhënien e gjuhës së huaj për qëllime specifike si dhe për zhvillimin e mesimit bazuar në mbajtjen e një lende tjetër shkencore. Ajo synon gjithashtu të familiarizojë studentet me mesimdhënje të gjuhës së huaj për grupe që duan ta mësojnë gjuhën e huaj për një afat të caktuar dhe të përfitojnë aftësi gjuhësore dhe kulturore për qëllime të qarta profesionale ose akademike.

Përshkrimi i programit

Në këtë lëndë studentët do të njihen me :

- Principet metodologjike të gjuhës së huaj për qëllime specifike në raport me gjuhën e huaj të përgjithshme
- Llojet e publikut dhe kërkesat e tyre për mësimin e gjuhës së huaj me qëllime specifike. Prezantimi i rasteve konkrete.
- Familjarizimi i mësuesit me mesimdhënien e gjuhës specifike.
- Gjuha e huaj në fushën e juridikut, mjekësisë, biznesit, turizmit.
- Ndërtimin e programeve të gjuhës së huaj për qëllime specifike, veprimtarive pedagogjike dhe simulimeve.
- Me një kuadër të shumëllojshëm situatash dhe ushtrimesh në gjuhë të huaj për profesione të ndryshme dhe realitete ndërkulturore.
- Ceshtje të vlerësimit.
- Aftësimi për përfitim sa më të lartë nga teksti i lexuar
- Nxjerrja e të dhënave nga pjesë të ndryshme leximi dhe shkrimi i punimeve shkencore

Literatura

Gotti.M, L'insegnamento delle LS per scopi specifici 1992.

Porcelli, G & alii L'apprendimento delle lingue speciali all'universita`

Mariani, L'apprendimento delle lingue all'universita`:le lingue speciali Bulzoni

Balboni 2002. Didattica delle microlingue

Metoda didaktike e mësimdhënies

Leksione, Seminare, Projekte

Mënyra e vlerësimit

Vlerësim I vazhdueshëm 20 %, presantim 30%, provim perfundimtar 50%

10. ITALISHTJA SI GJUHE E HUAJ E DYTE

Objektivat e lëndës

Në fund të kursit studentët duhet të jenë në gjendje të:

TË FOLURIT

Të pyesin dhe përgjigjen në mënyrë të pavarur për sa i përket çështjeve dhe temave të ndryshme.

Të komunikojnë me folës vendas të gjuhës italiane pa pasur probleme të të kuptuarit.

Të përdorin gjuhën italiane jo vetëm për kuptuar por edhe për të referuar në diskutime, për të debatuar ose për të argumentuar ide të ndryshme.

TË SHKRUARIT

Të përdorin pa probleme konceptet bazë të gjuhës në dokumente ose në materiale të ndryshme.

Të paraqesin argumente të ndryshme duke prezantuar punën e tyre me shkrim.

Të përpunojnë të dhëna pasi kanë studiuar një tekst letrar ose të komentojnë pa probleme pika të ndryshme referimi.

TË LEXUARIT

Të lexojnë dhe kuptojnë pa probleme artikuj nga gazeta, revista, romane, dhe të jenë të aftë të paraqesin analiza të detajuara të tyre.

Të eksplorojnë në gjuhën italiane duke arritur të kuptojnë pa probleme dhe të jenë në gjendje të nxjerrin përfundime.

TË DËGJUARIT

Të kuptojnë pa probleme një folës të gjuhës italiane.

Të kuptojnë dhe analizojnë ligjërata të gjata që kanë të bëjnë me fusha të ndryshme të shkencave sociale, etj.

Përshkrimi i programit

Lënda Gjuhë italiane si gjuhë e dytë zhvillohet në dy module të vendosura në semestrin e parë dhe të dytë .

Studentët do lexojnë tekste në lidhje me Italishten e përgjithshme dhe gjuhën e përdorur në klase. Do dinë të përdorin aftësitë e të lexuarit kritik në gjuhën e huaj si leximi për të marrë kuptimin, për të nxjerrë konkluzione.

Do përdorin strategji komunikimi.

Shkrimi i prezantimeve, organizim i mesimit në gjuhën italiane.

Puna me fjalor ta avancuar duke përdorur hamendësimin, nxjerrjen e kuptimit nga konteksti, njohjen e parashtesave dhe prapashtesave. Zgjerimin e fjalorit duke përdorur perkufizimin, përdorimin e fjaleve në fjali.

Literatura

1. Artan Fida, Viola Adhami «*Tipologjia e tekstit 3*», Shtëpia botuese «Maluka», Tiranë 2009.
2. Irena Ndoci Lama, Alessia Bergamin, Markeliana Anastasi, Aida Gjinali «*Tipologjia e tekstit 4*», Shtëpia botuese «Shkronjë pas shkronje», Tiranë 2013, 176 faqe, (ISBN 978999567814-2)

Metoda didaktike e mësimdhënies

Seminare, diskutime, projekte dhe prezantime

Mënyra e vlerësimit

20% pjesmarrje ne seminare, 10 % ese e bere ne shtepi, 20 test ne mes te simestrit, 50% provimi i fundit

12. METODOLOGJI E KERKIMIT SHKENCOR DHE KERKIM NE KONTEKSTIN PEDAGOGJIK TE GJUHES SE HUAJ

Objektivat e lendes

- Zhvillojë strategji për formulimin e çështjeve të kërkimit ,për mbledhjen dhe analizimin e të dhëna që kanë lidhje me këto çështje.
 - Të ndërtojë dhe komunikojë kërkimin duke u bazuar në teknika cilësore të kërkimit
- Të nxjerrë perspektivën epistemologjike që përshkron çdo kërkim në gjuhësinë e aplikuar.
- Dijë të justifikojë kriteret e përdorura për matjet dhe vlerësimet e bëra për gjuhën gjatë studimit.
- Komunikojë rezultatet e punimit në mënyrë që të shpjegohet qartë lidhja e tyre me lexuesin dhe studjuesin që ndjek punimin si dhe të ketë vlera referuese për të ardhmen.
- Identifikojë konsekuencat shoqërore të kërkimeve në gjuhësinë e aplikuar.
- Vlerësojë në mënyrë kritike studimet e botuara në fushën e gjuhësisë së aplikuar.

Pershkrimi i lendes

Kjo lëndë I njeh studentët me metodat e punës kërkimore të përdorura në fushën e gjuhësisë së aplikuar dhe në mënyrë të veçantë në kërkimet në gjuhën e huaj. Ajo trajton konceptualizimin dhe kryerjen e kërkimit, parashtrimin e çështjeve të kërkimit, grumbullimin dhe mbledhjen e të dhënave, përpunimin e tyre analiza e të dhënave dhe shkrimi dhe raportimi I kërkimeve

.Lënda I njeh studentët me ndryshimet midis kërkimit sasijor dhe cilësor, në lidhje me rolin e kërkuesit, me supozimet e tij për realitetin dhe duke vënë theksin në kërkimet në vendin e punës, në përdorimin e metodave të ndryshme, metodat statistikore të zakonshme si dhe në procesin e shkruarjes së punimit dhe përgatitjes së tij për botim.

Jepen shembuj dhe drejtim praktik per planifikimin e zhvillimin e punes kerkimore ne gjuhësinë e aplikuar. Studimi dhe analiza I kërkimeve të ndryshme të bëra në fushën e gjuhësisë së aplikuar dhe përfshirja e studentëve në studime kërkimore sasijore dhe cilësore në një shkallë më të ngushtë do aftësojë studentët për të vlerësuar dhe përdorur metoda dhe teknika të shumat të kërkimit në fushën e gjuhësisë së aplikuar .

Literatura

1. Kenneth N. Ross Quantitative research methods in educational planning
September 2005 © UNESCO
2. Cohen, Louis Research methods in education/Louis Cohen, Laërence Manion, and Keith
3. Handbook of research in second language teaching and learning / edited by Eli Hinkel.
2005 by Laërence Erlbaum Associates, Inc.
4. U. Eco, *Come si fa una tesi di laurea*, Milano, Bompiani.

Metodika e mesimit

Leksione, Seminare, Projekte

Vleresimi

Vleresim i vazhdueshem 20 %, prezantim 30%, provim perfundimtar 50%

13. LABORATOR TEORIK DHE PRAKTIK PER SHKRIMIN E TEMES SE PROVES FINALE

Objektivat e lëndës

- Njohjen e studentëve me parimet e përgjithme të shkrimit të një punimi masteri
- Aftësimin e studentëve për të ndjekur me kujdes të gjitha hapat e nevojshëm gjatë shkrimit -të punimit.
- Njohjen e studentëve me strukturat e ndryshme të ndërtimit të një punimi masteri
- Njohjen e studentëve dhe aftësimin e tyre për shkrimin e kapitujve të veçantë të punimit të masterit.
- Njohjen e studentëve me rregullat mekanike të shkrimit të punimit të masterit.
- Njohjen e studentëve me mënyrat e ndryshme të citimit apo edhe përdorimin e parafrazimit apo përmbledhjes.
- T'i bëjë studentët të aftë të shkruajnë një punim masteri i cili të jetë në përputhje me standardet e vendosura.

Përshkrimi i programit

- Hyrje në shkrimin e temës së masterit
- Hartimi i platformës
- Strukturat e ndryshme të punimeve të masterit
- Aspektet mekanike të shkrimit
- Shkrimi i Hyrjes
- Shkrimi i kapitullit të literaturës
- Shkrimi i kapitullit të metodologjisë
- Shkrimi i kapitullit të rezultateve
- Shkrimi diskutimeve
- Shkrimi i përfundimeve
- Shkrimi i abstraktit dhe falënderimeve
- Shkrimi i bibliografisë dhe citimeve

Literatura

- A. Capaccioni, *Ricerche bibliografiche*, Milano, Apogeo
- F. Bruni, *Manuale di scrittura e comunicazione*, Bologna, Zanichelli
- M. Cerruti, *Introduzione elementare alla scrittura accademica*, Roma-Bari, Laterza
- U. Eco, *Come si fa una tesi di laurea*, Milano, Bompiani

Metoda didaktike e mësimdhënies

Leksione , seminare

Mënyra e vlerësimit

Detyra kursi (puna praktike) + pjesëmarrje aktive – 50%

Provimi në mes të semestrit – 20 %

Provimi përfundimtar - 30%

14.PRAKTIKA PROFESIONALE

Praktika mësimore synon zhvillimin e aftësive të mësimdhënies së gjuhës së huaj, zbatimin praktik të metodave mësimdhënëse të përvetësuara për të provuar dhe vlerësuar njohuritë dhe bindjet për mësimdhënie të studentëve.

Gjatë saj realizohet vënia në praktikë e teorisë, metodave dhe teknikave të mësimdhënies me ndihmën dhe mbështetjen e një mësuesi me përvojë, marrje e drejtimit, feedback-ut dhe vlerësimit nga këshilluesi i tij, si dhe një reflektim dhe vetëvlerësim i praktikës profesionale.

Praktika vlerësohet me 12 kredite.

Në semestrin e parë të studimeve të Masterit zhvillohet 5 orë në javë praktikë pasive nëpër shkolla.

Në semestrin e dytë zhvillohet praktika aktive . Kohëzgjatja e saj është përcaktuar në programin mësimor dhe gjat nga data 1.03.2012- deri më 30.05.2012.

Para fillimit të praktikës, çdo student, duhet të kontaktojë me mësuesin e gjuhës së huaj të shkollës ku do të kryejë praktikën dhe të bëjnë së bashku përshkrimin e veprimtarive që do të kryhen gjatë praktikës dhe më pas ta konsultojë atë me pedagogun përgjegjës (dokumenti 1). Studenti ruan origjinalin e dokumentit 1 dhe i dorëzon një kopje mësuesit të gjuhës së huaj dhe pedagogut përgjegjës të praktikës në fakultet.

Pas realizimit të praktikës, mësuesi i gjuhës së huaj plotëson fletë –vlerësimin e studentit dhe e nënshkruan atë (dokumenti 2). Origjinalin e mban studentin dhe fotokopjen e dorëzon te pedagogu përgjegjës i praktikës.

Studenti në përfundim të praktikës pasive dhe aktive duhet të paraqesë një raport jo më pak se 10 faqe .

Nota përfundimtare do të dalë duke marrë parasysh vlerësimin gjatë praktikës dhe vlerësimin e raportit të praktikës të cilit i bashkëngjitet ditari i përgatitjes ditore gjatë ditëve të mësimdhënies, i kontrolluar dhe firmosur nga mësuesi i gjuhës së huaj.